



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	10.03.2021
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Elmedina Bajgora
Përmes/Preko/Through:	Drejtoris së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën përmes emailit zyrtar nga Elmedina Bajgora me të cilën kërkohet që me datë 3,4 dhe 5 Prill 2021 të bëhet shfrytëzimi i hapësirës publike „Sheshi ”Zahir Pajaziti”, parku i Gërmis si dhe në Taukbahçe. Qëllimi i aktivitetit është promovimi i produkteve “Bunchen”, “Huggies”, “Baby Nova”, si dhe shpërndarja e dhuratave për fëmijë.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në Sheshin ”Zahir Pajaziti”, parku i Gërmis si dhe në Taukbahçe me datën 3, 4 dhe 5 Prill 2021 sipas kërkesës së parashtruar.

Shpërndarja e fletushkave nuk lejohet sepse po hudhen në hapësirë publike.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHIP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.